



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/199 Dt. 07/02/2025

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 168 të Statutit të Universitetit, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren Ref.nr.01/120 të dt. 21.01.2025 mbi procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen XXVI të mbajtur më datë 05.02.2025, vendosi të shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për angazhimin të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, për semestrin veror të vitit akademik 2024/2025.

Konkursi shpallet sipas propozimeve të njësive akademike dhe atë si në vijim:

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Programimi i Orientuar në Objekte (SHK, 2 orë, O), Dizajnimi i Multimedive – SEW (SHK, 2 orë, O), Web shërbimet (SHK, 2 orë, O)
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Web Teknologjitë (SHK, 4 orë, O) Analiza e kërkesave të web-aplikacioneve (SHK, 2 orë, Z).
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Modelimi dhe simulimi elektronike (SHK, 2 orë, Z), Kontrolla Optimale dhe Optimalizimi -SK (SHK, 2 orë, O), Sistemet e Integruara dhe Hibride të Kontrollit – SK (SHK, 2 orë, O).
4. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Senzorë dhe Elektronika (SKIA, 3 orë, O), Vërejtje: lëndeve obligative i shtohet edhe njëra nga lëndët zgjedhore: Deep Learning-Metodat e aplikimi (SKIA, 2 orë, O), Kontrolli i lëvizjeve dhe dinamikës (SKIA, 2 orë, Z), Menaxhimi i energjisë (SKIA, 2 orë, Z), Inteligjenca artificiale e avancuar-metodat dhe aplikimi (SKIA, 2 orë, Z).

5. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Teoria e Kontrollës dhe praktikat (SKIA, 2 orë, O), Sistemet e bazuara në sensorë (SKIA, 2 orë, O).
6. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Metodologjia dhe Teoria e shkencave aplikative (SKIA, 2 orë, O), Automatizimi në industri (SKIA, 3 orë, O), Puna praktike (SKIA, 1 orë, O).
7. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Programimi II (SHK, 8 orë, O) Web Sherbimet- SEW (SHK, 2 orë, O)
8. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Web Teknologjite (SHK, 8 orë, O) Dizajnimi i Multimedive - SEW (SHK, 2 orë, O).
9. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Rjetat Kompjuterike (SHK, 8 orë, O) Modelimi dhe simulimi elektronike (SHK, 2 orë, Z).
10. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Mikrokontrolleret (SHK, 2 orë, Z). Rrjetat dhe Cloud (SHK, 4 orë, O).
11. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Zhvillimet per internet (SHK, 2 orë, Z), Hyrje në Inteligjencën Artificiale (SHK, 4 orë, O), Sensorët dhe Interfejsi (SHK, 2 orë, Z).
12. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Siguria e Rjetave –SW (SHK, 2 orë, O), Shkenca e të dhënave-SK (SHK, 2 orë, O), Kriptografia dhe Siguria e Rjetave-SK (SHK, 2 orë, Z), Sistemet e Shpërndara (SHK, 4 orë, O).
13. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Matematika II për informatike (SHK, 8 orë, O).
14. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Anglishtja per shkencat kompjuterike II (SHK, 8 orë, O).
15. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Programimi i Orientuar në Objekte (SHK, 4 orë, O), Analiza e kerkesave te web-aplikacioneve (SHK, 2 orë, Z), Programimi PLC (STC) - SK (SHK, 2 orë, O).
16. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Algoritmet dhe intelijenca artificiale (SKIA, 2 orë, O), Metodologjia dhe teoria e shkencave aplikative (SKIA, 2 orë, O), Automatizimi ne industri (SKIA, 2 orë, O).
17. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Matematika ne sistemet e inxhinierisë (SKIA, 2 orë, O), Teoria e Grafeve (SHK, 4 orë, O), Statistika dhe probabiliteti (SKIA, 2 orë, O).
18. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Kontrolla Optimale dhe Optimalizmi - SK (SHK, 2 orë, O), Sistemet e Integruara dhe Hibride të Kontrollit - SK (SHK, 2 orë, O), Deep learning - metodat dhe aplikimet (SKIA, 2 orë, O), Sensorë dhe Elektronika (SKIA, 2 orë, O), një lëndë zgjedhore varësisht prej zgjedhjes (SKIA, 2 orë, Z),
19. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: Menaxhimi i Sistemit te Informacionit- (E-qeverisja, 2 orë, Z), Databaza për e-qeverisje (E-qeverisja, 2 orë, O), Programimi dhe e-Qeverisja (E-qeverisja, 2 orë, O), Zhvillimet në Cloud (JU&EK) - (E-qeverisja, 2 orë, Z).

FAKULTETI JURIDIK

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët nga fusha E drejta civile: E drejta e kadastrit (BSc 2 orë, Z), E drejta e procedurës civile - Pjesa e posaçme (BSc, 3 orë,O).
2. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët nga fusha E drejta kushtetuese – administrative: E drejta kushtetuese pozitive (BSc, 3 orë,O), Gjyqësia kushtetuese (BSc, 2 orë, Z), E drejta administrative - Pjesa e posaçme (BSc, 3 orë,O), Rregullimi ligjor i Databazave (e- qeverisja, 2 orë, Z), Etika profesionale në E-Qeverisje (e- qeverisja, 2 orë, Z).
3. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtime në lëndët nga Fusha juridike-penale: Praktika Profesionale (BSc, 1 orë,O),Viktimologjia (BSc, 1 orë, O), Shkathësitë praktike gjyqësore (BSc, 1 orë, Z), Krimi i organizuar (BSc, 1 orë, Z), Psikologjia gjyqësore (BSc, 1 orë, Z), Kriminalistika (BSc, 1 orë, O).
4. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtime në lëndët nga Fusha E drejta financiare: Praktika Profesionale (BSc, 1 orë, O), E drejta financiare (BSc, 2 orë, O), Integrimet ekonomike evropiane (BSc, 4 orë, O).
5. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ushtime në lëndët nga Fusha E drejta juridiko-civile: E drejta romake (BSc, 1 orë, Z), E drejta familjare dhe trashëgimore (BSc, 3 orë, O), E drejta e kadastrit (BSc, 1 orë, Z), E drejta detyrimore (BSc, 2 orë, O), E drejta sendore (BSc, 3 orë, O), E drejta e procedurës civile-Pjesa e posaçme (BSc, 1 orë, O), E drejta kontraktore (BSc, 1 orë, O), E drejta noteriale (BSc, 1 orë, O), Praktika Profesionale (BSc, 1 orë, O),

FAKULTETI EKONOMIK

Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata/ushtime:

1. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata në lëndët: Aplikimi i softuerëve në biznes (BSc, 2 orë O), Bazat e teknologjisë së informacionit (BSc, 2 orë, Z).
2. Një bashkëpunëtor i jashtëm për ushtime në lëndët: Aplikimi i softuerëve në biznes (BSc, 2 orë, O), Bazat e teknologjisë së informacionit (BSc, 2 orë, Z).

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Certifikatën e lindjes;
- Kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë dhe doktoratë), të noterizuar me vulë origjinale nga noterit;
- Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për angazhim duhet të sjellin vendimin për nostrifikim të diplomës përkatëse (bachelor, master, doktoratë)
- Certifikatën e shtetësisë;
- Dëshmi për punimet shkencore, monografitë, tekstet mësimore, publikimet në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.;
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione të tjera lidhur me fushën e mësimdhënies;
- kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime, lektorit duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe atyre master të noterizuara me vulë origjinale nga noterit;
- Kandidati i cili konkurren në një njësi akademike, në disa pozita paraqet vetëm një palë dokumente, ndërkaq lëndët brenda një pozite nuk mund të ndahen;
- Certifikatën të lëshuar nga Gjykata që nuk jeni nën hetime;
- Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet.

Gjatë përzgjedhjes do të kenë përparësi kandidatët, të cilët kanë thirrje akademike, si dhe ata të cilët i kanë të përfunduara studimet bazike dhe të masterit në programe të rregullta, si dhe studimet e doktoratës nga fusha e ngushtë profesionale për lëndët që konkurrojnë.

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër është përparësi për aplikantët (për njohjen e gjuhëve të huaja, duhet sjellë dokumente të besueshme për njohjen e gjuhës së huaj). Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet bachelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHTI.

Universiteti mbanë të drejtën që për lëndët zgjedhore të shpallura në konkurs, nëse nuk formohen grupet, sipas Rregullores të mos nënshkruajë kontratë pune. Në rast se mungojnë orët për lëndët për të cilat zgjidhet mësimdhënësi/asistenti, kontrata e punës mund të ndryshohet.

Vlera e kompensimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të përcaktohet në bazë të Ligjit për Paga në sektorin publik Nr.08/ L-196 të dt. 05.01.2023 dhe Rregulloren për të ardhura personale të personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë pas ditës së publikimit. Pranimi i dokumentacionit bëhet nga data **07.02.2025 deri më 14.02.2025 në orën 16.00**. Paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën nr.4.

Kandidatët të cilë kanë qenë të angazhuar në vitin akademik 2023/2024 mund të dorëzojnë vetëm kërkesën për angazhim, përveç nëse kanë për të plotësuar dosjen me ndonjë të arritur të re.

Dokumentet e skanuara duhet ti dërgoni edhe në e-mail adresën elektronike: info@uni-gjilan.net. Aplikacionet e arritura pas afatit, të pakompletuara, si dhe dokumentacionet me diploma të panostrifikuara nga MASHTI dhe të pa noterizuara nuk do të merren në shqyrtim.

Mësimdhënësit/asistentët të cilët kanë marrëdhënie të rregullt pune në një universitet publik në Kosovë, pasi të pranohen në angazhim në UKZ duhet të sjellin lejen nga rektori i universitetit përkatës. Kandidatët për angazhim nuk mund ta kenë vend të tretë të punës angazhimin në UKZ. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit. <http://www.uni-gjilan.net>

